

Me bekimin dhe përkuajdesjen e Mitropolitit të Elbasanit, Shpatit dhe Librazhdit u zhvillua kampi 5-ditor pranë enorisë së Shën Gjergjit Kuqan.



Dukej qartë në fytyrat e fëmijëve, gëzimi për ditët e kampit që u zhvilluan rreth temës: "Unë jam i veçantë, siç je edhe ti".

Një ditë gjatë programit ishte: Lutja e mëngjesit, meditim, këngë të krishtera, mësim, punë dore dhe lojëra të ndryshme. Dita e fundit e kampit ishte një gëzim për gjithë kampin sepse të gjithë morëm pjesë në Liturgjinë Hyjnore të drejtuar nga prifti i famullisë At Petraq Dedja, gjithashtu patëm bekimin të merrnim pjesë në misterin e pagëzimit ku një pjestar i ri u shtua grigjës sonë.

Fëmijët kishin pregatitur një aktivitet festiv në fund të kampit ku përfshiheshin këngë, valle, recitime, dramë. Gjithashtu në këtë aktivitet festiv ishin të pranishëm

edhe prindërit e fëmijëve pjesmarrës në kamp.

nullisë At
ion.







Mitropolia e Shenjtë e Elbasanit, Shpatit dhe Librazhdit/facebook